



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot.
Dep.:	Br. Prot.
Dep.:	Prot. No.
Nr. i lag.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.10.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3465/12, për z. Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3465/12 që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes, ku është dyshuar për konflikt të interesit në ushtrimin e Funksionit Publik si Kryetar i Komunës së Shtimes dhe angazhimit të tij në veprimtari tjera private si Ligjërues në një Universitet Privat.

Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, pasi që z. Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes, nuk bie në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik pasi që neni 10.2 i po këtij ligji e lejon që zyrtari i lartë të ushtroj punë nga lëmi i arsimit nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.

Andaj duke vlerësuar gjendjen faktike konstatojmë se nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit, pasi që zyrtari i lartë z.Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes nuk gjendet në situatën konfliktit të interesit sepse angazhimi i tij, si mësimdhënës nuk paraqet mos

pajtueshmëri në ushtrimin funksionit publik, të parapare sipas ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

